

KËSHILLI PËR BASHKËPUNIM RAJONAL - PROJEKTI LABORATORI RINOR I BALLKANIT PERËNDIMOR  
TRAJNIM PËR ANËTARËT E GRUPIT RAJONAL TË EKSPERTËVE NGA KOSOVA\*

## METODOLOGJIA E LABORATORIT TË POLITIKAVE RINORE

1 dhjetor 2020, 09:30 – 13:10

### Hyrje

Laboratori i Politikave Rinore sjell qasjen me pjesëmarrje dhe të përqendruar tek rinia në proceset e hartimit të politikave. Ai ofron një hapësirë të sigurt për të rinjtë që të marrin pjesë në baza të barabarta me politikëbërësit dhe të angazhohen në mënyrë kuptimplote për zhvillimin e politikave, vlerësimin e politikave, ose rishikimet e politikave bazuar në parimet e bashkëmenaxhimit dhe bashkëprodhimit, ku të rinjtë dhe politikëbërësit ndajnë fuqinë për menaxhimin dhe zbatimin e hapësirave ku zhvillohen politikat. Laboratori i Politikave Rinore është një qasje, e cila u ofron vendimmarrësve mundësinë për të kuptuar më mirë realitetin, sfidat dhe nevojat e të rinjve në mënyrë që të punojnë së bashku me të rinjtë dhe të hartojnë bashkë zgjidhje të reja novatore për çështje të rëndësishme me të cilat përballen të rinjtë.

Aktivitetet kryesore për fillimin e Laboratorëve të Politikave Rinore janë Trajnimi mbi Metodologjinë e Laboratorit të Politikave Rinore dhe aktiviteti i hapjes së Laboratorit Rajonal Tematik të Politikave Rinore. Trajnimet në secilën ekonomi do të organizohen online në gjuhën lokale nga data 30 nëntor deri më 2 dhjetor përpara aktivitetit të hapjes. Aktiviteti i hapjes i Laboratorit Tematik Rajonal Rinor për Papunësinë e të

Rinjve që do të çojë në rekomandime politikash për të trajtuar papunësinë ndërmjet të rinjve do të mbahet në 14 dhe 15 dhjetor 2020 online për shkak të pandemisë COVID-19.

Trajnimet në gjuhën lokale do të zhvillohen në secilën ekonomi para aktivitetit të hapjes. Trajnimi do të shpjegojë të gjithë procesin e Laboratorit të Politikave Rinore dhe rolin e pjesëmarrësve. Trajnimi do të jetë ndëraktiv, me pjesëmarrje aktive, dhe do të shërbejë si mundësi për të shprehur mendime dhe për të diskutuar çështje të rëndësishme për Laboratorin e Politikave Rinore dhe papunësinë e të rinjve. Pjesëmarrësit do të njihen me temën e ciklit dhe do të angazhohen në një ushtrim/simulim praktik të Laboratorit të Politikave Rinore, si dhe do të diskutojnë rëndësinë e bashkërijimit nga aspekti i bashkëpunimit rajonal, ndërkohë që do të inkurajohet pjesëmarrja aktive.

Të gjithë të pranishmit do të respektojnë udhëzimet e rregullta për takimet online, duke u futur në platformën online të trajnimit të paktën pesë minuta para orës zyrtare të fillimit të aktivitetit, të kenë videon të ndezur, të bien dakord që trajnimet të regjistrohen në versionin audio dhe video, të fikin mikrofonin kur nuk flasin dhe të shmangin aktivitetet e zhurmshme ndërkohë që e kanë mikrofonin e ndezur.

09:30 09:40

Komente hyrëse

Adem Gashi, Drejtues Ekipi, Projekti  
Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor, RCC

09:40 10:30

Roli i Grupit Rajonal të Ekspertëve  
dhe njohja me njëri-tjetrin

Matej Manevski dhe Lindita Rexhepi, ekspertë

10:30 10:40

Pushim



## **METODOLOGJIA E LABORATORIT TË POLITIKAVE RINORE**

10:40 11:25

Laboratori i politikave rinore:  
për çfarë bëhet fjalë?

Matej Manevski dhe Lindita Rexhepi, ekspertë

11:25 11:40

Komente/feedback mbi Metodologjinë  
e Laboratorit të Politikave Rinore

11:40 12:10

Prezantimi i ekspertëve: Papunësia  
ndërmjet të rinjve në Ballkanin  
Perëndimor

Nand Shani, Drejtues i Ekipit të Platformës  
së Punësimit dhe Çështjeve Sociale, RCC

12:10 12:20

Pushim

12:20 13:00

Ushtrim/Simulim Praktik Laborator  
i Politikave Rinore

Tema: Papunësia te të rinjtë

Matej Manevski dhe Lindita Rexhepi, ekspertë

13:00 13:10

Vlerësimi i trajnimit



## METODOLOGJIA E LABORATORIT TË POLITIKAVE RINORE

### Projekti

Projekti tre-vjeçar i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga RCC-ja, me titull Projekti i Laboratorit Rinor i Ballkanit Perëndimor, i cili filloi në janar 2020, ofron mundësi për të rinjtë për të marrë pjesë në vendimmarrje. Projekti mbulon gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut) ku të rinjtë përbëjnë 21.27% të popullsisë së përgjithshme. Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor krijon një dialog rajonal të strukturuar afatgjatë midis organizatave rinore dhe administratave kombëtare, të përqendruar te krijimi i politikave të përbashkëta, i cili synon të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm social-ekonomik për të rinjtë dhe mobilitetin e të rinjve në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor përmes llojeve të ndryshme të aktiviteteve.

Projekti Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor përbëhet nga katër komponentë, të cilët janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Hartëzimi i politikave rinore dhe identifikimi i mbështetjes dhe mangësive ekzistuese për financimin e veprimeve rinore në Ballkanin Perëndimor
2. Laboratorët e Politikave Rinore të Ballkanit Perëndimor
3. Forcimi i Këshillave Kombëtare të Rinisë në Ballkanin Perëndimor
4. Pjesëmarrja e të rinjve të Ballkanit Perëndimor në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare

### Mekanizmat e BE-së për Dialogun me të Rinjtë dhe Trajtimin e Papunësisë ndërmjet të Rinjve

**Dialogu Rinor i BE-së:** Komisioni Evropian zbaton Dialogun Rinor të BE-së si një proces konsultativ dhe bashkë-krijues, i cili synon të rrisë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe të marrë kontributin e të rinjve. Dialogu Rinor i BE-së përfaqëson një mjet komunikimi të ndërsjellë midis të rinjve dhe vendimmarrësve. Dialogu Rinor i BE-së siguron një platformë për të rinjtë për të formësuar politikat evropiane dhe për të zbatuar përparësitë që burojnë nga bashkëpunimi evropian

për politikat rinore. Konsultimet në secilin shtet anëtar kryhen në të gjitha nivelet dhe procesi zbatohet përgjatë një periudhe 18-mujore. Konferenca e Rinisë së BE-së është aktiviteti kryesor që lidhet me procesin dhe organizohet nga shteti anëtar i BE-së që mban presidencën e BE-së.

**Garancia e të Rinjve (Youth Guarantee):** E prezantuar nga Komisioni Evropian në vitin 2013, Garancia e të Rinjve (GR) është një angazhim politik i ndërmarrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së për t'u dhënë të gjithë të rinjve nën moshën 25 vjeç një ofertë cilësore punësimi, arsimimi të vazhdueshëm, një praktikë pune ose stazh brenda katër muajve ose nga përfundimi i arsimit zyrtar, ose pasin bëhen të papunë. Përmes këtij instrumenti, BE-ja trajton papunësinë e të rinjve. Secili shtet anëtar ka një skemë kombëtare të Garancisë së të Rinisë, e cila është unike për atë vend. Këto aktivitete përfshijnë aftësim në bizneset lokale, trajnime që përziejnë përvojën në punë me orët teorike në klasë, oferta pune, financim për start-up-e ose vetëpunësim dhe kurse trajnimi.

**Plani Ekonomik dhe i Investimeve i BE-së për Ballkanin Perëndimor:** Në tetor të vitit 2020, Komisioni Evropian miratoi Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili për të rinjtë përmban Pikën 10 - Garancia për të Rinjtë. Përmes këtij plani, BE-ja u kërkon qeverive të Ballkanit Perëndimor të zbatojnë iniciativën e Garancisë për të Rinjtë në përputhje me Garancinë e të Rinjve të BE-së. Të rinjtë mundet potencialisht të përfitojnë në faza të ndryshme nga mbështetja e BE-së. Zbatimi duhet të kalojë nëpër katër faza, duke përfshirë 1) Planin e zbatimit; 2) Punën përgatitore; 3) Fazën pilote; dhe 4) Vendosi progresive/të përgjithshme. Në Ballkanin Perëndimor, vetëm Maqedonia e Veriut ka zbatuar Garancinë për të Rinjtë.

\* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS-të OKB-së 1244/199 dhe Opininionin e GjND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.